Kërkimi Shkencor - Strategjia dhe Struktura

- **Struktura e kërkimit shkencor**

Albanian University kryen veprimtari kërkimore–shkencore, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese sipas natyrës dhe objektivave specifike të fakulteteve. Për zhvillimin dhe organizimin e veprimtarisë kërkimore–shkencore në Albanian University, funksionojnë strukturat e kërkimit shkencor.

Struktura e kërkimit shkencor përfaqëson mekanizmin institucional përgjegjës për organizimin, koordinimin, mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë kërkimore shkencore, duke siguruar zbatimin e politikave të kërkimit, standardet e cilësisë dhe zhvillimin e bashkëpunimeve shkencore në nivel kombëtar dhe nërkombëtar.

- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor
- Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor dhe botimin
- Zyra e koordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike

Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike (ZKKSHBA)

Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike është njësia institucionale përgjegjëse për koordinimin, mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarisë kërkimore në universitet. Ajo vepron si strukturë qendrore për zbatimin e politikave dhe strategjive të kërkimit shkencor, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

ZKKSHBA ofron mbështetje administrative, teknike dhe institucionale për njësitë akademike, studiuesit dhe doktorantët në planifikimin, organizimin dhe monitorimin e aktiviteteve kërkimore. Gjithashtu, ajo koordinon proceset që lidhen me projektet kërkimore, publikimet shkencore, revistat akademike, bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe promovon integritetin akademik, etikën në kërkim dhe kulturën e cilësisë në veprimtarinë shkencore.

Në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm institucional, Zyra kontribuon në forcimin e kapaciteteve kërkimore, mbështet proceset e digjitalizimit dhe raportimit institucional, si dhe promovon pjesëmarrjen e universitetit në iniciativa, programe dhe rrjete kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Zyra e Kërkimit Shkencor ushtron funksionet e saj nëpërmjet këtyre përgjegjësive kryesore:

- Koordinon, mbështet dhe monitoron veprimtarinë kërkimore në nivel institucional.
- Ofron mbështetje administrative dhe teknike për aplikimin, zbatimin dhe raportimin e projekteve kërkimore.
- Mbështet publikimin e rezultateve shkencore në revista me reputacion dhe të indeksuara në databaza ndërkombëtare.
- Koordinon dhe mbështet botimin dhe zhvillimin e revistave shkencore të universitetit.
- Organizon trajnime, seminare dhe aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore të stafit akademik dhe studiuesve.
- Promovon shkencën e hapur (Open Access) dhe praktikat bashkëkohore të komunikimit shkencor.
- Zhvillon dhe koordinon bashkëpunimin me institucione akademike, kërkimore dhe partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë.
- Promovon veprimtarinë kërkimore dhe rezultatet shkencore të universitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Administron bazat e të dhënave, statistikat dhe treguesit e performancës së kërkimit shkencor, duke mbështetur proceset e raportimit institucional dhe të sigurimit të cilësisë.
- Mbështetjen e aplikimeve për fonde dhe grante kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Promovimin e integritetit akademik, etikës në kërkimin shkencor dhe respektimit të standardeve të publikimit.